



Thirrje për shprehje interesi për studentët
Debati universitar
Edicioni III
Programi Kombëtar i Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe
Ekonomik të Shqipërisë

Programi Kombëtar i Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Shqipërisë

Projekti: Debati Universitar Edicioni III - "Nga Fjala tek Veprimi"
Organizata: Qendra "Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim" (SCiDEV)

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

Afati i shprehjes së interesit: 19 Nëntor 2021

Konteksti

Prej dy vitesh me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Qendra 'Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim' (SCiDEV) ka zbatuar me sukses projektin 'Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë' në Tiranë Vlorë dhe Durrës. Përmes këtij projekti u bë i mundur përforcimi i njohurive dhe zhvillimi i analizës kritike të komunitetit të studentëve e kërkuesve të rinj lidhur me Integrimin Europian dhe ndikimin shumëdimensional të tij në Shqipëri përmes organizimit të kampionatit të debatit në auditorët universitarë, fushatave të komunikimit dhe ndërgjegjësimit online, shkrimit të artikujve nga studentë dhe pedagogë në rubrikën [Blog](#), organizimit të takimeve virtuale dhe konferencave me aktorë të tjerë. Në edicionin e dytë përveç debateve u realizua edhe fushata e titulluar "Nga fjala tek Veprimi" e cila përfshiu 8 të rinj debatues në përgatitjen e Policy Brief me gjetjet e tyre për problematikat e arsimit të lartë gjatë pandemisë. Këto gjetje u diskutuan në përballje direkte me kandidatët për deputetë duke bërë një aktivizëm konkret për të adresuar problemet dhe rekomanduar zgjidhjet e mundshme.

Debati Universitar – Edicioni III

Qëllimi i edicionit të tretë është të përforcojë aftësitë dhe mundësitë për veprim në jetën publike të studentëve përmes aktivizimit offline dhe online si edhe zhvillimit të aftësive analizuese, kërkuese, kritike, etikës në komunikim dhe tolerancës përmes debatit mbi sektorët kryesorë siç janë tematikat që përfshijnë më shumë të rinjtë si gjithëpërfshirja, punësimi, digjitalizimi, por edhe më gjerë, duke kontribuar direkt në përmirësimin e zhvillimit të politikave social-ekonomike për të ardhmen e për të qenë qytetarë proaktivë, të mirë-informuar, me mendim kritik e aftësi të të folurit në publik duke marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në komunitetin e tyre si dhe në jetën publike.

Bëhu pjesë!

A dëshiron të zhvillosh më tepër dijet dhe aftësitë rreth proceseve të zhvillimit ekonomik dhe social në Shqipëri apo më gjerë?

A dëshiron të zhvillosh aftësitë e të menduarit kritik, analizës së thellë, argumenteve të bazuara në evidenca, të folurim në publik?

A dëshiron të kontribuosh për një kulturë të rigjallëruar të debatit?

A dëshiron të jesh pjesë e një grupi të rinjsh proaktiv dhe që u dëgjohet zëri?

A dëshiron të jesh aktiv në komunitetin tënd dhe të bësh ndryshimin?

Atëhere, Programi Kombëtar i Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Shqipërisë dhe Debati Universitar Edicioni III - "Nga Fjala tek Veprimi" është për ty!

Studentët e interesuar të shprehin interesin e tyre duke iu drejtuar pedagogëve mentor në 14 universitetet pjesëmarrëse:

1. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD) – Elda Zotaj
2. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës – Oltjana Zoto
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT) – Klodiana Beshku
4. Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT) – Esmeralda Shehaj
5. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT) – Petrina Broka
6. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT) – Meljana Bregu
7. Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT) – Doris Malaj
8. Universiteti Europian i Tiranës (UET) – Klajdi Logu
9. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) – Holta Heba
10. Universiteti Marlin Barleti (MB) – Erona Leka
11. Universiteti Luarasi (Luarasi) - Dorina Gjipali
12. Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (UV) – Jonida Mehmetaj
13. Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër (UNISHK) – Alba Berberi
14. Universiteti Fan Noli, Korçë (UNIKO) – Benita Stavre

Informacion të mëtejshëm mund të gjeni në në faqen e projektit: <http://debate.scidevcenter.org/>

Afati: 19.11.2021